

5 korrik 2013, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Komuna e Mamushës zotohet për përmirësimin e transparencës online

Në kuadër të projektit të monitorimit të punës së ekzekutivit komunal të Mamushës, EC Ma Ndryshe gjatë muajit qershor është përqendruar në çështjet që kanë të bëjnë me transparencën e qeverisë lokale.

Monitorimi i transparencës online ka nxjerrë në pah mangësitë e theksuara në këtë drejtim. Ueb faqja e komunës si dhe komunikimi me publikun nuk është në nivelin e duhur dhe karakterizohet me mungesë të përcjelljes së informatave bazike për qytetarët. Përditësimi i të dhënave në ueb faqe nuk bëhet në asnjërin prej gjuhëve zyrtare të komunës së Mamushës. Vendimet e qeverisë komunale nuk publikohen online përderisa ka sfida të shumta edhe në zbatimin e praktikave për qasjen në dokumentet zyrtare, ku nuk përfillen në mënyrë strikte standardet e përkufizuara me ligjin përkatës.

Në anën tjetër, bazuar në raportin gjithëpërfshirës të institucioneve publike për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike, e lëshuar nga zyreja për komunikim me publikun të Zyrës së Kryeministrit, zbatimi i rregullorës 04/2012 për dëshimtë zyrtare që ndërlidhen me kërkesat për qasje në dokumente publike në nivel komunal, aplikohet nga ana e komunës së Mamushës, mirëpo rregullorja kërkon që palës dërguese t'i dërgohet konfirmimi për dëshminë e pranimit të kërkesës e që komuna e Mamushës në mesin e nëntë komunave tjera nuk lëshon një konfirmim të tillë.

Gjithashtu neni 7 i Rregullorës 04/2012 ka futur në zbatim nëntë formular të cilët janë pjesë përbërëse e procesit të kërkesës për qasje në dokumente publike e që komuna e Mamushës ka deklaruar se e përdorë vetëm formularin për regjistrim.

Njëherësh, raportimi i evidencave të kërkesave për qasje në dokumente publike u raportohen me ligj MAPL-së, Zyrës së Kryeministrit dhe të dyjave së bashku, komuna e Mamushës në lidhje me kanalin e raportimit, mban anën negative në mesin e tetë komunave, obligimin e kryhen përmes Departamentit të Administratës Komunale e që është në kundërshtim me obligimin ligjor.

Obligimet që dalin nga ligji për qasjen në dokumente publike në lidhje me ngritjen e kapaciteteve, trajnim për procedura dhe ekzekutim të kërkesave, sipas zyrtarit nga kjo komunë nuk i është ofruar asnjë trajnim që del nga obligimet e ligjit.

EC Ma Ndryshe gjatë këtij muaji i ka evidentuar këto mangësi dhe i ka adresuar tek lidhshiptari i komunës. Këta të fundit e kanë pranuar pjesën e tyre të përgjegjësisë, duke i arsyetuar me burimet e pamjaftueshme njerëzore, për shkak të numrit të vogël të personelit.

Megjithëkëtë kryetari i komunës, Arif Bütüç është zotuar se do të bëj përpjekje për të përmirësuar transparencën online sikurse edhe praktikatat e qasjes në dokumentet zyrtare. Ai i ka ofruar bashkëpunim EC Ma Ndryshes dhe organizatave tjera të shoqërisë civile që të përkrahin komunën e Mamushës në rritjen e nivelit të transparencës me ofrimin e ekspertizës së nevojshme, duke premtuar se do të vërë në dispozicion dokumentet dhe informatat e nevojshme.

EC Ma Ndryshe vlerëson se komuna e Mamushës përkundër kufizimeve që ka duhet të tregoj përkushtim më të madh për zbatimin e standardeve të qeverisjes së mirë, që si shtyllë kryesore kanë transparencën.

EC Ma Ndryshe rekomandon komunën e Mamushës që të zbatoj Udhëzimin Administrativ 2008/09 të MAPL-së për rritjen e transparencës si dhe të raportoj më shpesh në ueb faqe dhe në media për çështjet që lidhen me përdorimin e buxhetit komunal, zhvillimin ekonomik, përdorimin e pronës komunale, planifikimin urban, investimet, të hyrat komunale, etj.

EC Ma Ndryshe gjithashtu përshëndet gatishmërinë e lidhshimit komunal për të bashkëpunuar me shoqërinë civile në drejtim të rritjes së nivelit të transparencës.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të komunave Prizren dhe Mamushë, publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

*Projekti "Transparenca online e komunës së Mamushës" prej muajit maj 2013
përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.*